

VENDIM
Nr. 13, datë 16.2.2016

MBI TARIFËN FIKSE TË ENERGJISË ELEKTRIKE, QË DO T'U PAGUHEJ
PRODHUESVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE, NGA HIDROCENTRALET PËR VITIN
2016

Në mbështetje të neneve 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, nenit 15, pika 3, të ligjit nr. 138/2013, “Për burimet e energjisë së rinovueshme”, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1033, datë 16.12.2015, “Për miratimin e metodologjisë të përcaktimit të tarifave fikse të energjisë, që do t’u paguhet prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet”, si dhe pikën 3 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 156, datë 24.12.2015, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 16.2.2016, pasi shqyrtoi relacionin e drejtorive teknike mbi tarifën fikse të energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet për vitin 2016, si dhe informacionin shtesë të kërkuar,

konstatoi se:

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1033, datë 16.12.2015, ka miratuar “Metodologjinë e përcaktimit të tarifave fikse të energjisë që do t’u paguhet prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet”, në të cilën është përcaktuar se $\text{Çmimi i shitjes (lekë/kwh)} = \text{Çmimi mesatar i vitit përkatës të bursës hungareze (HUPX) të energjisë elektrike në euro cent/kwh} \times \text{koeficientin } 1.24 \times \text{normën mesatare të këmbimit në euro/lekë për vitin e fundit.}$

- Raportit vjetor (*Physical Futures Annual Report*) nga bursa e Hungarisë HUPX për vitin përkatës është botuar.

- Bordi i ERE-s, në pikën 3, të vendimit nr. 156, datë 24.12.2015, ka përcaktuar se, pas publikimit të raportit vjetor (*Physical Futures Annual Report*) nga bursa e Hungarisë HUPX për vitin përkatës, siç përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1033, datë 16.12.2015, ERE do të shprehet me vendim “Mbi miratimin e tarifës fikse të energjisë për vitin 2016, prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet”.

- Bordi i ERE-s, në pikën 2, të vendimit nr. 156, datë 24.12.2015, ka përcaktuar se: Fuqia juridike e vendimit nr. 27, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, datë 16.2.2015, “Mbi miratimin e tarifës fikse të energjisë për vitin 2015, që do t’u paguhet prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet”, zgjatet deri në marrjen e vendimit të shfuqizimit të tij nga Bordi i ERE-s.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Tarifa fikse e energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet për vitin 2016, do të jetë 7.448 lekë/kwh.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi nr. 27, datë 16.2.2015, i Bordit të Komisionerëve të ERE-s, “Mbi miratimin e tarifës fikse të energjisë për vitin 2015, që do t’u paguhet prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet”.

3. Diferencat që mund të rezultojnë ndërmjet çmimit të miratuar për vitin 2016 dhe çmimit të miratuar për periudhën e ndërmjetme me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 156, datë 24.12.2015, do të sistemohen nëpërmjet korigjimit të faturimeve përkatëse.

4. Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve të njoftojë të interesuarit për vendimarrjen e Bordit të EREs. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2016.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti